



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Bulevardi "Zogu I", Tiranë Tel: +3554 2259817, Fax: +3554 2259822 www.kld.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2016

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

(Mbajtur, më 04.11.2016)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit, për vitet 2007-2009, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve" për:

1. Gjyqtar Petrit Çomo, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
2. Gjyqtar Sokol Tona, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
3. Gjyqtar Ridvan Hado, Gjykata e Apelit Tiranë;
4. Gjyqtar Agim Bendo, Gjykata e Apelit Tiranë;
5. Gjyqtare Fiqirete Mullaj, Gjykata e Apelit Tiranë;
6. Gjyqtare Fatmira Hajdari, Gjykata e Apelit Tiranë;
7. Gjyqtare Etleva Deda, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
8. Gjyqtare Marjana Dedi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
9. Gjyqtare Blerina Muça, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
10. Gjyqtar Amarildo Laçi, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë;
11. Gjyqtare Albana Boksi, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;
12. Gjyqtar Fuat Vjerdha, Gjykata e Apelit Shkodër;
13. Gjyqtare Dhurata Haveri, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;
14. Gjyqtare Fran Prendi, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Drejton mbledhjen Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Zoti Bujar Nishani.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Filloi orën 11:35 dhe mbaroi në orën 15:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Bujar Nishani (kryetar)*
- 2. Ylli Manjani (anëtar)*
- 3. Astrit Haxhialushi (anëtar)*
- 4. Gjini Gjoni (anëtar)*
- 5. Gerd Hoxha (anëtar)*
- 6. Petrit Çomo (anëtar)*
- 7. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 8. Eneida Civici (anëtare)*
- 9. Ridvan Hado (anëtar)*
- 10. Neritan Cena (anëtar)*

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, **Artan Broci**, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. **Vangjel Kosta**.

Shënim 2: Zoti Sokol Çomo, zonja Albana Shtylla dhe zoti Xhezair Zaganjori nuk marrin pjesë në këtë pikë të rendit të ditës.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Marsida Xhaferllari, Kryeinspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 2. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse e sektorit të Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit.*

6. Elis Kuçi, Zëdhënës për shtypin pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

7. Olsi Kristo, Këshilltar Ligjor pranë Presidencës.

8. Edlira Bako, Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

9. Eksperte e Misionit EURALIUS IV.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit, për vitet 2007-2009, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” për:

1. Gjyqtar Petrit Çomo, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
2. Gjyqtar Sokol Tona, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
3. Gjyqtar Ridvan Hado, Gjykata e Apelit Tiranë;
4. Gjyqtar Agim Bendo, Gjykata e Apelit Tiranë;
5. Gjyqtare Fiqirete Mullaj, Gjykata e Apelit Tiranë;
6. Gjyqtare Fatmira Hajdari, Gjykata e Apelit Tiranë;
7. Gjyqtare Etleva Deda, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
8. Gjyqtare Marjana Dedi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
9. Gjyqtare Blerina Muça, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
10. Gjyqtar Amarildo Laçi, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë;
11. Gjyqtare Albana Boksi, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;
12. Gjyqtar Fuat Vjerdha, Gjykata e Apelit Shkodër;
13. Gjyqtare Dhurata Haveri, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda;
14. Gjyqtare Fran Prendi, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Bujar Nishani: Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës. Shqyrtimi i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit, për vitet 2007-2009, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve” për... Në vijimësi, ju lutem Kryeinspektorja.

Petrit Çomo: Më fal, zoti President!

Meqenëse unë e kam emrin i pari, s’duhet të marrë pjesë.

Bujar Nishani: Në rregull. Atëherë tërhiq. Zoti Petrit Çomo tërhiqet. Tërhiqet vetëm për vlerësimin e tij. Nuk është me kundërshtim. Është i pa kundërshtuar si vlerësim.

Marsida Xhaferllari: Janë pa ankime.

Gjyqtari Petrit Çomo, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek të tre komponentët. Ka marrë njoftim në datën 4 korrik 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

(Nuk merr pjesë në votim zoti Petrit Çomo.)

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin për gjyqtarin Petrit Çomo?

Dhjetë (10).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Sokol Tona, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike”, “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Ka marrë njoftim në datën 7 korrik 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin e gjyqtarit Sokol Tona?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Po, zoti Ridvan!

Ridvan Hado: Largohem meqenëse është vlerësimi për personin tim.

Bujar Nishani: Dakord. Tërhiqet nga procedura zoti Ridvan Hado.

Urdhëroni, Kryeinspektorja!

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Ridvan Hado, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerësohet për veprimtarinë e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitet 2007-2009, propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek të tre komponentët. Është njoftuar në datën 7 korrik 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

(Nuk merr pjesë në votim zoti Ridvan Hado.)

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin për gjyqtarin Ridvan Hado?

Dhjetë (10).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Agim Bendo, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerësohet për veprimtarinë gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitet 2007-2009. Është njoftuar në datën 07.07.2016 dhe nuk ka paraqitur ankim. *(Gjyqtari është vlerësuar “Shumë mirë” në dy grupet e para të vlerësimit dhe “Mirë” në grupin e tretë dhe në përfundim është vlerësuar “Shumë mirë”).*

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin e gjyqtarit Agim Bendo?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Fiqirete Mullaj, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerësohet për veprimtarinë e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2007-2009. Është njoftuar në datën 19 korrik 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim. *(Gjyqtarja është vlerësuar “Shumë mirë” në dy grupet e para të vlerësimit dhe “Mirë” në grupin e tretë dhe në përfundim është vlerësuar “Shumë mirë”).*

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin e gjyqtares Fiqirete Mullaj?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Fatmira Hajdari, në Gjykatën e Apelit Tiranë, vlerësohet për veprimtarinë e saj gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2007-2008 *(lapsus, 2007-2009)*, propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat

i vlerësimit “Shumë mirë” tek të tre komponentët. Është njoftuar në datën 19 korrik 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin e gjyqtares Fatmira Hajdari?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Etleva Deda, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek dy komponentët “Aftësitë profesionale të përgjithshme dhe “Aftësitë profesionale juridike dhe teknike” si dhe “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Ka marrë njoftim në datën 19 korrik 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin përfundimtar të gjyqtares Etleva Deda?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Marjana Dedi, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike”, “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Ka marrë njoftim në datën 14 korrik 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin përfundimtar të gjyqtares Marjana Dedi?

(Zoti Cena ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Urdhëro!

Neritan Cena: Pavarësisht se Marjana Dedi s’ka paraqitur ankim (e ka vlerësuar vet, është e drejta e saj), por tani është e çuditshme. Marjana Dedi është lektore në magjistraturë, që e dimë të gjithë, të paktën mua, Gerdit, edhe zonjës Civici edhe Brunës i ka dhënë mësim... Po mirë, ç’rëndësi ka.

(Zoti Hoxha flet pa ndezur mikrofonin.)

Mirë! Kërkoj ndjesë.

Bujar Nishani: Ju lutem, mos ndërhyini.

Neritan Cena: Tani, tek pjesa e vlerësimit për pjesëmarrjen në magjistraturë e nxjerrin “Mirë”. Është turp. Një zysh magjistrature e nxjerrim “Mirë”, pavarësisht se ajo mund të mos ketë bërë ankim. E kupton? Logjikisht nuk shkon. Mendoj unë.

Bujar Nishani: Nuk e gjykojmë dot nëse nuk e hetojmë dot administrativisht pastaj procesin. Në qoftë se ka kërkesë për ta hetuar administrativisht procesin...

Po, urdhëro Kryeinspektorja!

Marsida Xhaferllari: Vlerësohet kjo gjyqtare për veprimtarinë gjyqësore në vitet 2007-2009 dhe në faqen 13 të projekt-aktit bëhet me dije që përgjatë 3 viteve të vlerësimit ajo ka marrë pjesë vetëm në 3 ditë të formimit vazhdues. Dhe megjithatë, duke marrë në konsideratë edhe këtë tregues, ndonëse me këto 3 ditë, për 3 vjet ishte në nivelin “E paaftë”, është vlerësuar në nivelin “Pranueshëm”. Angazhimi i saj si autore e librit Pronësia intelektuale, i botuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2005, pra përpara periudhës së vlerësimit (sepse vlerësojmë për vitet 2007-2009), i është marrë sërish si tregues, dhe angazhimi në procesin e mësimdhënies të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, dhe është vlerësuar “Mirë” në këtë komponent. Duke i mbledhur të katër kriteret e grup kriterit të fundit “Pranueshëm”, “Mirë” dhe dy “Shumë mirë” për “Etikën” dhe “Solemnitetin”, është arritur në konkluzionin që rezultati përfundimtar për këtë grup kriter duhet të jetë “Mirë”.

Neritan Cena: A janë përfshirë kur ka qenë lektore në magjistraturë? Se të jesh lektor në magjistraturë, duhet të merret edhe ajo në konsideratë. Apo duhet të jetë pjesëmarrje. Të jesh lektor, je ai që drejton seminarin. Logjikisht. Nuk e di a është përfshirë apo jo.

Marsida Xhaferllari: ...të angazhuar si lektore në procesin e mësimdhënës të formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës. Ligji "Për Shkollën e Magjistraturës" përcakton detyrim për gjyqtarët të marrin pjesë në programin e trajnimit vazhdues të tyre dhe në këtë program të trajnimit vazhdues, që është i ndryshëm nga trajnimi fillestar, gjyqtarja Marjana Dedi ka marrë pjesë vetëm 3 ditë në 3 vjet.

Bujar Nishani: Faleminderit!

Mirë! Atëherë, dakord me vlerësimin përfundimtar të zonjës Marjana Dedi?

Kush është dakord?

Dy, katër, gjashtë, tetë, dhjetë (10).

Kundra?

Një (1).

Miratohet.

Vazhdojmë!

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Blerina Muça, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike dhe teknike” dhe “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Ka marrë njoftim në datën 28 shtator 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin përfundimtar të gjyqtares Blerina Muça?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Amarildo Laçi, aktualisht pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është vlerësuar për veprimtarinë e tij në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda në vitet 2007-2009, propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek të tre komponentët. Është njoftuar në datën 7 tetor 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin përfundimtar të gjyqtarit Amarildo Laçi?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Albana Boksi, pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë

mirë” tek të tre komponentët. Ka marrë njoftim në datën 7 tetor 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin përfundimtar të gjyqtares Albana Boksi?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtari Fuat Vjerdha, pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, njëherazi kryetar i saj, propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale të përgjithshme”, “Shumë mirë” tek “Aftësitë profesionale juridike” dhe “Mirë” tek “Aftësitë e kapacitetit njerëzor”. Ka marrë njoftim në datën 5 tetor 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord për gjyqtarin Fuat Vjerdha si vlerësim përfundimtar?

Njëmbëdhjetë (11).

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: Gjyqtarja Dhurata Haveri, pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, propozohet vlerësimi i saj “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek të tre komponentët. Ka marrë njoftim në datën 26 tetor 2016 dhe nuk ka paraqitur ankim.

Bujar Nishani: Kush është dakord me vlerësimin përfundimtar të gjyqtares Dhurata Haveri?

Njëmbëdhjetë (11) pro.

Kundra, s’ka.

Miratohet.

Marsida Xhaferllari: I fundit është gjyqtari Fran Prendi, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, propozohet vlerësimi i tij “Shumë mirë”, si rezultat i vlerësimit “Shumë mirë” tek të tre komponentët. Është njoftuar në datën 1 nëntor 2016 dhe ka shënuar se nuk ka ankim.